



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prudato Received/Delivery	31. 05 2021	viti god year	
Organ/Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPESHUK	2740/2021		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.350/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2338/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 29.04.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.425/2019 të datës 25.07.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë: Këndi i Rrugës "Bill Clinton dhe Dëshmorët e Kombit"-Zyra e ATK-së, Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 31.05.2021 mori këtë:

**V E N D I M**

**Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr. 425/2019 e datës 25.07.2019 e parashtruar nga ankuesi**

**A r s y e t i m**

Ankuesi sipas Akt Emërimit me nr.02/736/09 të datës 15.05.2018 në pozitën Drejtor i Departamentit të Lojërave të Fatit në Administratën Tatimore të Kosovës, ka pranuar njoftimin e Drejtorit të Përgjithshëm të datës 14.05.2019 për miratim e strukturës së re organizative të Administratës Tatimore të Kosovës.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 14.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, ka parashtruar ankesë me datë 12.06.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me datë 11.07.2019 ka nxjerr Vendimin Nr.144 duke refuzuar ankesën e ankuesit si të papranueshme.

Ankuesi, kundër vendimit Nr.144 të datës 11.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës me datë 25.07.2019 ka parashtruar ankesë në



Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.07.2019 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Administratën Tatimore të Kosovës. Këshilli, me datë 08.08.2019 me numër protokoll 3481/2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me datë 29.04.2021 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.2338/19 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtojë dhe të vendos për ankesën e datës 25.07.2019 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes meritorie ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 25.07.2019 me numër protokoll 3293/2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Projekt Rregulloren nr. ATK13/2019 të datës 17.05.2019; Vendimin me numër Nr.87/2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 04.05.2018; Raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 02.05.2018 me numër prot:2557/2018; Vendimin me numër prot:333 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së të datës 13.06.2019; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 30.04.2018; Strukturën organizative të ATK-së të datës 10.05.2019; Akt emërimit e ankuesit të datës 15.05.2018 me nr. prot: 02/736/09; Vendimin me numër prot:144 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve e dhe të Ankesave të datës 11.07.2019; Strukturën organizative të ATK-së të datës 15.03.2016; Njoftimin e Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së të datës 14.05.2016; Ankesën e ankuesit të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës të datës 08.07.2019; Përgjigjen në kërkesë të datës 08.08.2019 dhe numër protokoll 3481/2019; E-mailin e datës 24.06.2016 dërguar nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 16.05.2019 dërguar nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 14.05.2019 dërguar nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; Ankesën e ankuesit të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës të datës 12.06.2019; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Inspektor i Njesisë Hetuese në ATK; Njoftimin e datës 06.09.2019 si dhe Aktgjykimin me numër A.nr.2338/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 29.04.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit \_\_\_\_\_ është shqyrtuar paraprakisht, andaj mbi këtë bazë ligjore kolegji merr vendim për **Përfundim të Procedimit Administrativ, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i cili përcakton se: "Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon



se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike”, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës sipas Aktgjykimit A.nr.2451/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me datë 28.05.20 ka nxjerrë vendimin A.nr.336/2021 duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të datës 04.09.2019, ankesë e cila ka pasur të njëjtin qëllim dhe është bazuar mbi të njëjtën situatë faktike sikurse ankesa e datës 27.05.2019 e cila për objekt shqyrtimi ka Vendimin më numër prot:333 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së të datës 13.06.2019, andaj mbi këtë bazë Kolegji merr vendim për përfundim të procedimit administrativ pasi që për të njëjtën çështje Këshilli ka vendosur paraprakisht.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me A.nr.350/2021**

**Elakron GASHI**



Zyrtarë i Lartë për BASHKËPUNIM profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Menaxherit të Personelit në Administratës Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.